

KONTRIBUTI I SEFË MLEQANIT NË PERFORMIMIN  
E KËNGËVE EPIKE

Ilir A. Dugolli, “*Sefë Mleqani dhe këngët e tij epike*”, botoi: Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2020; 372 f.



Krahina e Llapushës, rajon etnogeografik ndërmjet Rrafshit të Dukagjinit e të Drenicës, është shumë e njohur për traditën e këndimit. Ajo dhe etnokultura janë fort të lidhura dhe të pandashme. Kur ia përmend emrin, të kujtohet trashëgimia e saj e madhe shpirtërore, të kujtohen sidomos tri majat më të larta të artit të këndimit: Sefë Mleqani me Salih Krasniqin e Feriz Krasniqin. Libri për Sefën, i autorit Ilir Dugolli, *Sefë Mleqani dhe këngët e tij epike*, po u shtohet veprave të Tahir Foniqit, Muharrem Gashit e Ismet Krasniqit, kushtuar Salihit e Ferizit, kurse Llapushën e bëjnë edhe më të njohur në fushën e studimeve albanologjike.

Pasardhësit e Sefë Mleqanit e të Salih e Feriz Krasniqit sot, po edhe të rreth 100 rapsodëve të tjerë në dy

shekujt e fundit, e vazhdojnë këndimin lirik dhe epik në Llapushë, e cila veçohet ndër shumë vise të atdheut, të ndarë në gjashtë shtete, për ruajtjen e kultivimin e këngëve epike heroike legjendare të Eposit të Kreshnikëve, kryevlerë e folkorit kombëtar. Për këtë flasin dy vëllime me këngë të tilla për Mujin e Halilin me shokë, të mbledhura nga rapsodët e Llapushës. Ato janë gjurmuar e mbledhur në kuadër të Projektit E5 të Z. U. Nezirrit, me 15 vëllime, në pesë shtete të Ballkanit, në vitet 2012-2016, që janë dëshmi për dosjen qeveritare, e përgatitur për t'i paraqitur këto këngë në UNESCO, si vlerë e trashëgimisë kulturore të njerëzimit.

Struktura e veprës së Ilir Dugollit, *Sefë Mleqani dhe këngët e tij epike*, qëndron mbi pesë shtylla. E para, Sefa: vendlindja, repertori, kreshnikët, baladat dhe këngët me karakter fetar, epika historike, lirika. E dyta, Sefa: Eposi heroik, narracioni dhe miti; personazhet, veprimet, virtytet, topografia; legjendariteti, fantastikja dhe mitikja, si 6 tekste kreshnikësh. E

treta, Sefa: atdheu e rapsodia; pasardhësit e tij ose Sefëmleqanët, si i quajnë ndryshe, repertori dhe llojet, nga lirika e deri te balada dhe epika heroike. E katërta, Sefa: dëshmi, dokumente dhe 6 djemtë e tij: Imeri, Asmani, Xhaferi, Brahimi, Ismeti, Beqiri, pasardhës të denjë, atdhetarë të njohur dhe rapsodë të dalluar. E fundit, kujtime për Sefën, nga rapsodët: Bajram Baja, Rifat Dragaj, Musli Musliu, Habib Kryeziu, Vesel Marmullaku, Isë Llapçeva, Zenel Zekolli e Rifat Berisha.

Sefë Mleqani tashmë është emër për histori në fushën e etnokulturës në krahinën e Llapushës. Ai u bë i njohur edhe në Drenicë, në Rrafshin e Dukagjinit dhe në viset e tjera. Në repertorin e tij kishte shumë këngë lirike, epike historike dhe epike legjendare, sidomos të Eposit të Kreshnikëve, që i këndonte me lahutë. Incizimet e Sefës janë përhapur edhe në viset tona jashtë Kosovës. Këngët e tij i kanë mësuar përmendsh dhe i kanë kënduar rapsodët tanë mërgimtarë edhe në Evropën Perëndimore. Këto të dhëna i ka hulumtuar me kujdes autori Ilir Dugolli.

Kënga e tij epike jehoi në fejesa, dasma e gazmende. Ajo i forcoi ndjenjat për atdheun në kohën e robërisë jugosllave. Këndoi në kohën kur këngët epike ishin të ndaluar nga pushteti dhe me atë pushtet ka pasur probleme, por këngën nuk e ka ndalur asnjëherë, as ai e as djemtë e tij: Imeri, Asmani, Xhaferi, Brahimi, Ismeti, Beqiri. Kënga e tij i ndihmoi shumë sidomos Lëvizjes Kombëtare,

që nuk pushoi së vepruari deri në luftën Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ku kjo familje dha kontribut të rëndësishëm, kurse i biri i Sefës, Beqiri, u shpall Hero i Kosovës. Mbi këto tipare dhe vlera, autori ka bërë përpjekje që ta portretizojë Sefë Mleqanin, rapsod dhe atdhetar.

Te pjesa teorike e shqyrtimit të eposit heroik legjendar të atyre gjashtë këngëve të Eposit të Kreshnikëve, që u botuan në shtojcë të këtij libri, autori ka bërë hulumtime studimesh të autorëve tanë, sidomos për shtyllat e tij kryesore: legjendariteti, fantastikja dhe mitikja. Për të triat jep edhe shpjegime, përmes citimeve të autorëve tanë. Mbi to janë ndërtuar edhe këngët e kënduara nga lahutari Sefë Mleqani. Autori shtron edhe çështjen e dallimit të eposit heroik legjendar dhe të eposit heroik historik, e përbashkëta dhe dallimet ndërmjet tyre, që përbëjnë pjesën kryesore të repertorit të Sefë Mleqanit.

Ana teknike – shkencore e veprës së Ilir Dugollit, *Sefë Mleqani dhe këngët e tij epike*, është hartuar sipas standardeve të nevojshme kërkimore - shkencore, sipas projektimit, që nga ideja fillestare për shkrimin e saj. Ajo është redaktuar me kujdes në të gjitha fazat e punës dhe është recensuar nga studiuesit prof. dr. Adem Zejnullahu dhe prof. dr. Sadri Fetiu.

Vepra ka fjalorth të fjalëve të rralla, pasqyra të hulumtimeve në terren, në arkiva e në biblioteka, po edhe ka burimet dhe literaturën, si dhe një përfundim në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze.

Gjuha e komunikimit me lexuesin e dallon këtë vepër. Ajo është e kuptueshme, e afërt. Mendimet janë të qarta dhe tështruara si duhet. Janë edhe të argumentuara. Stili është përkatës për monografitë e këtij lloji. Asaj ia shton vlerën edhe notografia e hartuar nga Alban Feka, që është shumë me interes për etnomuzikologët.

Unë kam pasur nderin që bashkëpunova me autorin, se isha redaktor i kësaj vepre të rëndësishme, por së bashku ishim që nga fillimi i idesë për hartimin e saj, në bashkëbisedë me të birin e Sefës, Imerin, po ashtu rapsod. Ilir Adil Dugolli, nga Nikajt ose Nekoci i Drenicës, Komuna e Drenasit, nga familja atdhetare Dugolli, është veteran dhe invalid i luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, historian, publicist, master i filozofisë, autor artikujsh dhe i monografisë për dy rapsodët e Drenicës, Selman Haradin Bala dhe Adil Cenë Dugolli. Punon në Pallatin e Rinisë dhe të Sporteve në Prishtinë, në cilësinë e kryeshefit ekzekutiv. Premton, pas këtij libri, edhe botimin e një vëllimi me këngë të Sefë Mleqanit.

Kjo monografi e Ilir Dugollit për rapsodin e shquar Sefë Mleqani solli një ndihmesë të re në folkloristikën shqiptare, e cila ka nevojë shumë të madhe për botime të këtilla, që e thellojnë njohjen e etnokulturës sonë, e popullarizojnë dhe e ruajnë ndër breza. Ajo e pasuron vargun e botimeve të Institutit Albanologjik, duke paraqitur jetën e njërit nga rapsodët më të dalluar që ka pasur Llapusha dhe Kosova në shekullin e kaluar.

**Zymer UJKAN NEZIRI**

